

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Ramiz Azizi, me zyrtaren ligjore Florentina Ademi, në lëndën penale ndaj të akuzuarve B.M. dhe F.M., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafin 1.4 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.934/17 e datës 08.06.2017, të cilën e përfaqësonte prokurori i shtetit Shefik Mehmeti, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 28.12.2017, mori dhe shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

1. I akuzuari **B.M.**, nga babai R. dhe nëna Sh. e lindur P., i lindur më data e lindjes..., në ..., ku edhe tani jeton, rruga: ‘ ... nr. ... i pamartuar, ka kryer shkollën e mesme, I pa punësuar ,i gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, nuk ka qenë i dënuar me parë për ndonjë veprë tjetër penale.

2. I akuzuari **F.M.** nga i babai Sh. nëna M., e lindur B., i lindur më datë data e lindjes... në fsh. ... Komuna ..., jeton në ... rruga “ ... ” nr ..., i pa martuar, ka kryer shkollën e mesme, i punësuar profesioni instalues, i gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka qenë i dënuar më parë për veprë tjetër penale dhe as nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij

Janë Fjator
Sepse

Me datë ... rreth orës 11:27 te autolarja “ ... ” në rrugën e ... në ..., të pandehurit B.M. dhe F.M. nga ..., në bashkëveprim lehtë e lëndojnë E.Sh. nga ... në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që kishin pasur në ditë më parë i pandehuri B.M. dhe i dëmtuari E.Sh., i pandehuri B.M. së bashku me të pandehurin e dytë F.M. shkojnë të autolarja “ ... ”, për të biseduar me E. i cili ishte duke e pastruar motoçikletën dhe aty fillimisht fyhen mes vete e pastaj i pandehuri B. e godet të dëmtuarin me grushta në pjesë të ndryshme të trupit ndërsa i pandehuri i dytë fillimisht e godet me grushta në trup e pastaj me një mjet të papërshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rënd trupor – daltë e metalt.

-me çka në bashkëveprim kan kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me par.1 nënpar 1.4 lidhur me nenin 31 KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4,7,17,21, 49, 50,51,52 e 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365, 451 dhe 463 të KPPRK-së, atij shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të dy akuzuarve B.M. dhe F.M. iu caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej nga 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve të cilin dënim të pandehurit nuk do ta vuajën, nëse në afat prej 1 (një) viti, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale.

Obligohet të dy të pandehurit që të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 € secili, si dhe shpenzimet e tjera të procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e vet të lartcekur ndaj të akuzuarve B.M. dhe F.M. nga ..., për shkak të veprës lëndim i lehtë trupor në bashkëveprim nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nënparagrafi 1.4, nga KPRK.

Në shqyrtimin gjyqësor fillestar, të datës 28.12.2017, prokurori i shtetit Shefik Mehmeti, në fjalën përfundimtare të saj, pos tjerash pohoi se qëndron në tërësi pranë aktakuzës së lartcekur, duke kërkuar nga gjykata që të akuzuarin ta shpalli fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Të akuzuari B.B. dhe F.M., në fjalën e tyre përfundimtare pohojnë se ndjejnë veten fajtor, e kërkojnë nga gjykata që t'i dënojnë me një dënim sa më të butë, duke premtuar se një gjë të tillë më kurrë nuk do ta përsërisin.

Gjykata, pas dëgjimit edhe të Prokurorit të Shtetit, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase të pandehurit i kuptojn natyrën dhe pasojat e pranimit të fajtit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga të pandehurit; pranimi i fajtit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se të pandehuri B.M. dhe F.M. nga ..., me dashje e ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor në bashkëveprim , nga neni 188 par2 lidhur me par.1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i shpalli fajtor të pandehurit B.M. dhe F.M. nga ..., për shkak të veprës penale në bashkëveprim – lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK, ngase veprimet e të njejtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njejtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurve B.M. dhe F.M. nga ... gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73 të KPRK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se të pandehurit e kanë pranuar fajësinë, se, ka shprehur keqardhje për kryerjen e kësaj vepre, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me kusht, ndaj të pandehurit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 50 të KPRK.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, kurse vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i përgjithshëm

Më 28.12.2017

**Zyrtarja ligjore,
Florentina Ademi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ramiz Azizi**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.